



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 151/1 Prot

Tiranë, më 09.03.2022

V E N D I M

Nr. 31, datë 09.03.2022

Mbi përfundimin e hetimit administrativ, për vlerësimin e ligjshmërisë së ecurisë disiplinore zhvilluar ndaj nëpunëses ***, e cila ka përfunduar me marrjen ndaj saj të masës disiplinore “Largim nga shërbimi civil”.**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të nenit 90, të ligjit nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, pas shqyrtimit të materialit të përgatitur dhe propozimit të paraqitur prej Drejtorisë së Përgjithshme të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, për trajtimin e informacionit të përcjellë nga nëpunësja ***** , për shkelje të legjislacionit të shërbimit civil gjatë zhvillimit të procedurës disiplinore dhe marrjes së vendimit për largim nga shërbimi civil, nga ana e Komisionit Disiplinor.

VËREJ SE:

Nëpërmjet kërkesës së regjistruar me nr. 942, datë 27.09.2021, nëpunësja ***** ka ngritur pretendimin se ndaj saj ka filluar dhe është zhvilluar një ecuri e padrejtë disiplinore, në shkelje të ligjit material dhe atij procedural, e cila ka përfunduar me marrjen e masës disiplinore “Largim nga shërbimi civil”.

Nga shqyrtimi i materialeve të dërguara nga institucioni Autoriteti i Konkurrencës, rezulton se kërkuesja ***** është nëpunëse civile prej vitit 2010, në pozicionin e “Specialistes së Financës, Buxhetit dhe Komunikimit”, në këtë institucion.

Fillimi i efekteve të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, e ka gjetur në atë pozicion, kështu që cilësia e të qenit nëpunëse civile, konsiderohet e konfirmuar.

Thelbi i mosmarrëveshjes që përbën objektin e këtij hetimi administrativ, lidhet me faktin se njësi përgjegjëse e institucionit, pasi ka konstatuar një sërëshkeljesh në lidhje me kryerjen e detyrës si “Specialiste e Financës, Buxhetit dhe Komunikimit”, prej nëpunëses *****, të cilat kanë konsistuar kryesisht në mosrespektimin e afateve të pagesave të kuotave të sigurimit të detyrueshëm të punonjësve të institucionit, apo detyrime të ndryshme tatimore, etj, për të cilat ajo është ndëshkuar me gjoba administrative edhe nga ana e organeve tatimore, nëpërmjet shkresës nr. 427 dt. 22.09.2021, ka kërkuar fillimin e ecurisë disiplinore ndaj saj.

Mbi këtë bazë, nga ana e institucionit, me Urdhrin nr. 3 datë 22.09.2021 të Sekretarit të Përgjithshëm, është ngritur Komisioni Disiplinor (plotësuar me Urdhrin nr. 4 datë 22.09.2021 për ngritjen e Sekretariatit Teknik të tij).

Rezulton se, Komisioni i Disiplinës, me shkresën nr. 427/2 dt. 22.09.2021, ka njoftuar nëpunësen për fillimin e ecurisë disiplinore, duke përcaktuar dhe ditën e fillimit të seancës dëgjimore, në dt. 29.09.2021. Me shkresën nr. 427/4 prot, datë 09.10.2021, nëpunësja *****, është vënë në dijeni për seancën dëgjimore për të dhënë shpjegime, në lidhje me shkeljet e konstatuara nga eprori i saj, gjatë kryerjes së detyrave si Specialiste e Financës, Buxhetit dhe Komunikimit.

Në përfundim të shqyrtimit të çështjes në disa seanca, Komisioni Disiplinor ka arritur në përfundimin se shkeljet janë natyrës së rëndë e mbi këtë bazë, me vendimin nr. 427/5 prot, datë 19.10.2021, është marrë masa disiplinore “Largim nga shërbimi civil” për nëpunësen *****, me motivacionin për mospërbushje të rëndë të detyrave, të cilat kanë sjellë pasoja të rënda në mirëfunksionimin e institucionit.

Së fundmi, bazuar në vendimin e mësipërm të Komisionit Disiplinor, për marrjen e masës disiplinore “Largim nga shërbimi civil”, njësi përgjegjëse ka njoftuar nëpunësen për shkeljet të marrëdhënive të punës dhe ato financiare me institucionin.

Nga sa u parashtrua më sipër dhe nga analiza në tërësi e dokumentacionit të administruar arrihet në përfundimin që, veprimet e njësisë përgjegjëse vlerësohen se nga pikëpamja e zbatimit të rregullave procedurale, dhe detyrave që i ka ngarkuar ligji, janë kryer në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dispozitat përkatëse të legjislacionit të shërbimit civil dhe në veçanti nenet 54, 55, e 56, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar.

Ndërkaq, gjatë zhvillimit të procesit të verifikimit nga Komisioneri, konstatohet se për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së mësipërme, kërkuesja *****, i është drejtuar me padi edhe Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, e cila e ka regjistruar padinë me nr. 4717 akti, dt. 08.11.2021 dhe në dt. 15.11.2021, ka filluar shqyrtimin e çështjes gjyqësore.

Duke qenë se për këtë mosmarrëveshje, tashmë ka nisur rruga e shqyrtimit gjyqësor, bazuar në nenin 36, të Kodit të Procedurave Civile, sipas të cilit, asnjë institucion nuk mund dhe nuk duhet të marrë në shqyrtim një çështje që është duke u trajtuar nga organet gjyqësore, pasi është kjo që do ti japë zgjidhje përfundimtare problemit duke rregulluar edhe pasojat që kanë ardhur, prej saj, Komisioneri vlerëson që të përfundojë hetimi administrativ dhe të arkivohet çështja me konstatimin e mësipërm, në lidhje me procedurën e ndjekur nga ana e njësisë përgjegjëse dhe Komisioni Disiplinor.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencës së përcaktuar në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, në nenin 90 pika 2, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe në nenin 34, pika 1, të të Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr.17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1-Përfundimin e hetimit administrativ, me objekt vlerësimin e ligjshmërisë së ecurisë disiplinore dhe vendimit për “Largim nga shërbimi civil” të nëpunëses ***** , filluar në bazë të kërkesës së saj me nr. 942, datë 27.09.2021 dhe duke qenë se çështja është duke u shqyrtuar në tërësinë e saj, nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, çështja të arkivohet.

2- Të njoftohet për këtë vendiminstitucioni Autoriteti i Konkurrencës Tiranë dhe nëpunësja *****.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

PranveraStrakosha